

**MARRËVESHJE TRANSFERIMI TË PJESËVE TË KAPITALIT
TË SHOQËRISË “EL&EL Construction Shpk” SH.P.K.**

Në Tiranë, sot më 07 / 10 / 2025, palët e kësaj Marrëveshjeje ranë dakort si më poshtë:

Shitësi:

- **Znj. Elis Sinani**, shtetase shqiptare, lindur me 27/07/1990, ne Tirane, mbajtese e dokumentit te identifikimit me nr. personal J05727073S, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;;

(më poshtë referuar “Shitësi”)

Dhënës Pëlqimi:

- **Z. Andi Sinanaj**, shtetas shqiptar i lindur me 07.06.1989 ne Tirane, Shqiperi dhe banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit elektronik me nr. 034304763 dhe nr. personal I90607068P, në cilësinë e bashkëshortit të **Znj. Elis Sinani**.

(më poshtë referuar “Dhënës Pëlqimi”)

Blerësi:

- **“G88 Construction” Sh.p.k**, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me seli ne: Rr Ibrahim Rugova, Nr.5 Sky Tower, Ap.12/4, Tirane me numer pasurie 3/219 + 1 – 36, Zona Kadastrale 8270, Tirane, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me NIPT M51417035Q, perfaqesuar nga Administratori Z. Danjel Garunja, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, mbajtes i mjetit te identifikimit me nr. Personal I80515074D, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;


(më poshtë referuar “Blerësi”)

MEQËNËSE:

- A. Shitësi zotëron 50% të Kapitalit të Shoqërisë **“EL&EL Construction Shpk” Sh.p.k**, një shoqëri ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me **NIPT M51824031I**, me seli në: Rruga Hysni Gerbolli, Pallati Ultratech, Shkalla C, Kati 2, Ap 55, ZK.8310, Tirane, (“Shoqëria”), me një kapital prej 100.000 (njëqind mijë) Lek.
- B. Blerësi dëshiron të blejë 50 % te Kapitalit të Shoqërisë të zotëruar nga Shiteshi në shoqërinë e lartpermendur **“EL&EL Construction Shpk” Sh.p.k** siç përcaktohet në këtë marrëveshje.
- C. Në përputhje me **Ligjin Nr. 9901**, datë 14.04.2008, **“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”**, i ndryshuar dhe nenet e Statutit të Shoqërisë, Ortaket kane marrë vendimin përkatës për transferimin tek Blerësi shoqëria **“G88 Construction” Sh.p.k**, të 50% te kapitalit si më sipër.

PER SA ME SIPER, palët bien dakort si më poshtë:

1. Shitësi pranon se ka marrë nga Blerësi në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord në vlerën, prej 5000 Euro dhe për këtë arsye transferon ketu 50% të Kapitalit të zotëruar nga Shitësi **Znj. Elis Sinani** tek Blerësi shoqëria **“G88 Construction” Sh.p.k**.



Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se 50% te kapitalit që transferohet këtu është në pronësinë e tij të plotë ligjore dhe të lirë nga barra, hipoteke apo pengje.

2. Blerësi pranon pronësinë e 50% të kapitalit të shoqërisë, duke njohur gjendjen e Shoqërisë dhe bien dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i Kuotave brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.
3. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, ortakë të shoqërisë dhe pjesët e kapitalit të zoteruara prej tyre në shoqërinë “ **EL&EL Construction Shpk** ” Sh.p.k. do të jenë:
 - Shoqëria “**G88 Construction**” Sh.p.k. - zotëron 1 kuote me 50 % të kapitalit të shoqërisë.
4. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

DHËNËS PËLQIMI

Z. Andi Sinanaj bashkëshort i **Znj. Elis Sinani**, ortake në shoqërinë “ **EL&EL Construction Shpk** ” Sh.p.k me 50% te kapitalit te shoqërise për efekt të martesës deklaron se është dakord që 50% të kapitalit, objekt i kësaj kontrate, në pronësi të bashkëshortes së tij, t’i shiten shoqërisë “**G88 Construction**” Sh.p.k.

Dhënësi i pëlqimit **Z. Andi Sinanaj**, deklaron se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë vendimmarrje të bashkëshortes së tij për shitjen e 50% të kapitalit që zotëron në shoqërinë “ **EL&EL Construction Shpk** ” Sh.p.k dhe nuk do ketë asnjë pretendim në të ardhmen lidhur me këtë shitje.

Kjo Marrëveshje u hartua në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me vlerë të barabartë ligjore. Marrëveshja bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar. Marrëveshja u lexua nga palët, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre.

SHITËSI

Elis Sinani

Elis Sinani

BLERËSI

SHOQËRIA “G88 Construction” SH.P.K.

Perfaqesuar nga

Administratori

Danjel Garunja

Danjel Garunja

DHENESI I PELQIMIT
Andi Sinanaj

